

# Pasojat e inflacionit të kreditë me probleme do të shfaqen brenda një viti

**N**gadalësimi i rritjes ekonomike pritet të ndikojë negativisht edhe në cilësinë e kredisë së sektorit bankar. Orjada Kulla, Drejtore e Departamentit të Risqeve të Integruara në Credins Bank, thotë për "Monitor" se, mbështetur në modelet statistikore, efektet negative do të jenë të dukshme brenda një viti. Sipas saj, ngadalësimi i rritjes ekonomike dhe rritja e shpejtë e normave të interesit do të ngadalësojnë ritmet e huadhënies gjatë vitit 2023.

**Inflacioni i lartë pritet të sjellë efekt negativ në ritmet e rritjes së PBB-së dhe në fuqinë paguese të agjentëve ekonomikë. Besoni se një situatë e tillë shtrun rreziqe reale për rritje të raportit të kredive me probleme? Sa kohë mund të duhet për të parë efekte negative në cilësinë e portofolit të kredisë?**

Inflacioni, ritmet e rritjes së PBB-së, luhajtjet e kursit të këmbimit etj., janë faktorët kryesorë makroekonomikë që bankat testojnë në ecurinë e portofolit të kredive. Këta faktorë, në kombinim me karakteristikat e portofolit të çdo banke, përcjellin impaktin e ecurisë ekonomike në raportin e kredive me probleme. Modelet statistikore që ne përdorim për testimin e efekteve kanë vërtetuar lidhjen negative midis PBB dhe nivelit të kredive me probleme, pasi një ekonomi e shëndetshme dhe e zhvilluar do të ndikonte në rritjen e të ardhurave, uljen e papunësisë dhe në ciklin e biznesit, të cilat do të rrisnin cilësinë e portofolit të kredisë. Në të kundërt, në situata të stresit ekonomik do të kishim rënie të PBB dhe rritje të kredive me probleme. Nga këto testimet rezultojnë se efektet janë më të dukshme në një horizont kohor njëvjeçar, ndaj mund të themi që brenda një viti do të kemi efektet e para në cilësinë e portofolit të kredive.

**Në këndvështrimin tuaj, cilat segmente të klientëve huamarrës mund të jenë më të ndjeshëm ndaj pasojave të inflacionit të lartë dhe rritjes së normave të interesit?**

Për sa u përket segmenteve të klientëve më të ndjeshëm ndaj pasojave të inflacionit dhe rritjes së normave të interesit, mendoj që kategoria më e prekur do të jenë klientët individë. Kjo nuk i përjashton segmentet e biznesit, të cilët gjithashtu po përballen në mënyrë të menjëhershme me rritjen e kostove në tërësi, nevojën për financim dhe presionin për mbajtjen e marzheve të pranueshme të fitimit.

**Në Deklaratën e fundit të Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë vlerëson**



**se muajt në vijim mund të jenë sfidues për ekonominë shqiptare, për shkak të ndikimit që mund të përcjellë situata e pafavorshme energjetike dhe bankat mund të përballen me ulje të mëtejshme të fitimit e ndoshta edhe me humbje financiare. Si e vlerësoni situatën e lidhur me efektet e shtrenjtimit të energjisë në kostot e prodhimit dhe në aktivitetin e biznesit? Çfarë masash po merrni për t'u përballur me skenarë të mundshëm negativë në portofolat tuaj?**

Kjo është një situatë e pazakontë, pas shumë vitesh në një kontekst ekonomik të qëndrueshëm dhe pozitiv. Bankat do të kenë rolin kryesor në përballimin e kësaj situatë të pafavorshme, e cila është ende në fazën fillestare. Siç është shpjeguar edhe më sipër, të gjitha rritjet e kostove të biznesit, të kombinuara me faktorët makroekonomikë në tërësi, do të ndikojnë në cilësinë e portofolit të kredive të bankave. Rënia e cilësisë së portofolit, përkthehet në mënyrë të drejtpërdrejtë në rënie të fitimit, dhe në raste ekstreme, edhe në humbje financiare. Përballimi i situatës patjetër që do të jetë sfidues për bankat, por sistemi bankar do ta menaxhojë këtë ndikim nëpërmjet diversifikimit të investimeve, menaxhimit efektiv të rrezikut dhe rivendosjes së ekuilibrave të nevojshëm në treguesit kryesorë.

**Sipas statistikave sektoriale, deri tani inflacioni i lartë dhe rritja e ndjeshme e normave të interesit nuk po japin efekt të dukshëm në ritmet e huadhënies. Kur mendoni se mund të fillojmë t'i shohim pasojat e kësaj situatë në ecurinë e kreditimit të ekonomisë?**

Në fakt, është ende herët për të vënë re efekt të dukshëm në ritmet e huadhënies. Rritja e normave të interesit, edhe pse dha sinjalet e para menjëherë pas fillimit të konfliktit në Ukrainë, u materializua me ritme më të shpejta në 6-mujorin e dytë të vitit 2022, si rezultat i mekanizmave të Bankave Qendrore për të frenuar inflacionin. Në këto kushte, efektet e normave të interesit në huadhënie, mendoj se do të bëhen më të dukshme në vitin e ardhshëm.

**A keni filluar të aplikoni kritere më të kujdesshme të huadhënies, qoftë të shprehura në çmim (ritje e normave të interesit) apo kushtet e tjera jo çmim (raporti i kështit ndaj të ardhurave, mbulimi me koleteral, etj.)?**

Bankat, gjithnjë e më tepër, po shkojnë drejt kriterëve më prudente të huadhënies, të shprehura në të gjithë komponentët e vendimmarrjes, duke vlerësuar në mënyrë të plotë e të kujdesshme ndryshimet e tregjeve dhe situatën ekonomike.

**Këtë vit, normat e interesit po rriten me ritme më të shpejta se ato që parashikohen zakonisht në skenarët bazë të analizave të ndjeshmërisë (stress-testeve). Cilat janë sfidat kryesore që shtrun për bankat tregtare rritja e shpejtë e normave të interesit?**

Rritja e normave të interesit ka qenë shumë e shpejtë këtë vit, kryesisht në 6-mujorin e dytë. Bankat gjithnjë kanë përfshirë ndryshimin e normave të interesit në stress-testet e ushtruara, duke i konsideruar këto efekte në mënyrë parësore në ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit. Përcaktimi i efekteve në cilësinë e portofolit të kredive ka qenë relativisht i limituar. Cilësia e portofolit të kredive është ndikuar më tepër nga faktorë të tjerë. Kjo ka ndodhur për shkak të një periudhe të gjatë, me norma interesi të qëndrueshme dhe kosto të lira financimi. Në kushtet aktuale, kur normat e interesit pritet të kenë efekt edhe në cilësinë e portofolit të kredive, sfidat kryesore për bankat do të jenë përcaktimi i ekuilibrave të rinj në marzhet e ndërmjetësimit dhe proaktiviteti në përballimin e rreziqeve. ■